

Me rastin e Asamblesë së pestë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 10 korrik 2008,

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Olavi Snellman, Andrea Cruciani, Angela Kaptein; Michael Zimmermann, Norbert Koster, Christine Lindemann-Proetel, Michael Simmons, Gerrit-Marc Sprenger; Gianfranco Gallo; Emilio Gatti.

Njëzëri miraton VENDIMIN

Të aprovohen Udhëzimet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale në gjykatat e qarkut.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

UDHËZIME PËR ALOKIMIN E LËNDËVE PËR GJYKATËSIT E EULEX-IT NË LËNDËT PENALE NË GJYKATA TË QARKUT

I. Hyrje

Sipas Ligjit të Jurisdikcionit¹ dhe Alokimin e Lëndëve, gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca primare ose ekskluzive dhe kompetenca shtesë në lëndët penale.

Kompetencat primare janë paraparë në nenin 3.1, dhe ato shtesë në nenet 3.3, 3.4, 4.1, 4.3, dhe 4.5.

Kompetenca primare duhet të konsiderohet si “e zakonshme”, gjë që do të thotë që çdo lëndë që i përket kësaj hipoteze duhet të gjykohet nga gjykatësit e EULEX-it (GJE)².

¹ “Ligji mbi Jurisdikcionin, përzgjedhja e lëndëve dhe alokimi i tyre për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë” nr. 03/L-053, lëshuar më 13 mars 2008 (LmJ)

Kompetenca shtesë është “e mundshme” dhe në hipoteza të ndryshme, kërkon një arsye të veçantë dhe vendimin specifik të Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.

Një gjë e tillë mundëson mendimin që a) proporcioni ndërmjet numrit të lëndëve që u përkasin kompetencave primare dhe numrit të lëndëve që u përkasin atyre shtesë është më i madh në favor të të parave b) lëndët për kompetenca shtesë do të njihen paraprakisht dhe si pasojë do të alokohen në mënyrën më të mirë në panel.

Kompetenca primare është e disenjuar sipas kompetencave për hetimin dhe ndjekjen e kryer nga Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së KOSOVËS (ZPSRK)³.

Ligji mbi ZPSRK⁴ parasheh dy lloj kompetencash për krimet e kryera si dhe tentativat, e para shihet si “ekskluzive” (neni 5) dhe e dyta si “shtesë” (neni 9).

Është e rëndësishme të ceket se në të dy rastet kur ZPSRK-ja kryen hetimin apo ndjekjen penale, kompetenca primare e gjykatësve të EULEX-it është e bazuar.

Neni 5 (kompetenca ekskluzive) dhe neni 9 (kompetenca shtesa) përmbajnë një listë nominative krimesh, paraparë nga Kodi Provizor Penal i Kosovës (KPPK), i cili hyri në fuqi më 6 prill 2004 **si dhe** një listë nominative të përbërë nga krimet serioze, paraparë nga Kodi Penal i Republikës Socialiste-federale të Jugosllavisë (KPRSFJ) dhe nga Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPK).

Kjo do të thotë që krimet më serioze janë kompetencë e ZPSRK-së (prandaj, edhe të gjykatësve të EULEX-it) nëse janë kryer apo ka pasur tentativë para datës 6 prill 2004 (sipas KPRSFJ-së dhe KPK-së) dhe nëse janë kryer që nga ajo ditë (sipas KPPK-së).

Sipas nenit 5.1 të LmZPSRK-së, ka indikacion të jetë kompetencë ekskluzive e Zyrës së Prokurorisë Speciale për krime⁵ terrorizmi, gjenocidi, krime kundër njerëzimit, krime lufte, përfshirë këtu edhe thirrjen nën armë apo marrjen në shërbim të personave nën moshën 18 vjeçare, krime të ndërlidhura me materiale nukleare, krime të organizuara, të parapara nga KPPK-ja, të kryera pas datës 6 prill 2008.

² Një përfshirje ofrohet nga neni 3.2 në LmJ, sipas të cilit Kryetari i Asamblesë së EULEX-it mund të vendosë “me arsye” të mos caktojë gjykatës të EULEX-it në një ndër këto lëndë.

³ Neni 3.1 në LmJ: “Gjykatësit e EULEX-it, të caktuar në procedurë penale do ta kenë jurisdiksion dhe kompetenca mbi lëndët e hetuara apo të ndjekura penalisht nga ZPSRK”.

⁴ “Ligji mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës” nr. 03/L-052, lëshuar më 13 mars 2008 (LmZPSRK).

⁵ Për listën e saktë, shihni aneksin 1.

Sipas nenit 5.2⁶, që është kompetencë primare e ZPSRK-së, gjithashtu përfshihen edhe krimet e terrorizmit siç parashihet nga KPSFRJ-së, Rregullores së UNMIK-ut 2001/12⁷ dhe krimet e parapara në nenet 141-155 të KPRSFJ-së⁸.

Mund të konkludohet që të **gjitha** lëndët që janë **kompetencë ekskluzive** e ZPSRKK-së përmbajnë fakte të **dhunës** ndaj njerëzve apo së paku ndaj **krimit të organizuar**.

Neni 9.1 i LmZPSRK-së shënon 24 lloje të krimeve⁹ që nga sulmi mbi rendin ligjor të Kosovës, nxitjen e urrejtjes racore, fetare apo etnike, mosmarrëveshje apo jotolerancë, trafikim të qenieve njerëzore, vrasje, rrëmbime, torturë, shkelje e integritetit seksual, dhe blerja e paautorizuar e substancave narkotike (lit. a – n) e deri te krimet më serioze ekonomike (që shkaktojnë falimentimin, shpëlarjen e parave, evazionin fiscal, zhatje, dhënien dhe marrjen e mitos dhe të ngjashme: lit. o - z).

Sipas nenit 9.2, që është kompetencë shtesë e ZPSRK-së, përfshihen gjithashtu disa krime serioze të parapara në KPK-në, në KPRSFJ-në dhe në disa rregullore të UNMIK-ut¹⁰.

Një numër i madh krimesh që janë kompetencë shtesë e ZPSRK-së kanë karakter ekonomik dhe një gjë e tillë mund të ketë efekt të rëndësishëm në nën-ndarjen e lëndëve në mes të paneleve gjyqësore.

2. Kompetencat shtesë të gjykatësve të EULEX-it, të parapara në nenet 3 dhe 4 të LmJ-së.

Hipoteza e parë (neni 3.3) ndodh kur Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, me kërkesën e palës me të drejtë, konsideron ngarkimin e GJE-së “si të nevojshëm për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë”¹¹ dhe kushtet që kanë të bëjnë me diskualifikimin e gjykatësit, jo të aplikueshme.

⁶ Për këtë dhe dokumente të ngjashme, shihni aneksin 2.

⁷ RREGULLORJA NR. 2001/12 UNMIK/REG/2001/12 14 qershor 2001 në ndalimin e terrorizmit dhe kundërvajtjet e tilla.

⁸ Kryesisht gjenocidi, krimet e luftës dhe krimet e lidhura me diskriminimin racor.

⁹ Shihni listën e saktë në aneksin 3.

¹⁰ Kryesisht vrasja, trafikimi i qenieve njerëzore, krime ndaj dinjitetit personal dhe moralit, prodhimi dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike, nxitja e urrejtjes racore, fetare apo etnike, mosmarrëveshje dhe jotolerancë, rastet e rënda të vjedhjes dhe grabitjes, zhatje, marrje dhe dhënie e mitos, shihni aneksin 4.

¹¹ Kjo nevojë spjegohet në nenin 3.5 të LmJ-së për hipotezën e kërcënimeve ndaj GJK-së, dëshmitarëve apo palëve, gjë e cila mund të shkaktojë një “dështim serioz të drejtësisë” poqese lënda mbahet si përgjegjësia ekskluzive e GJK-së.

Është e rëndësishme të vrojtohet që kjo kompetencë ipet vetëm për krime të cilat supozohen si të veçanta dhe që kanë lidhje me kompetencat shtesë të ZPSRK-së (nenet 9.1 dhe 9.2 të LmZPSRK-së).

Kompetenca shtesë e GJE-së ndodhë vetëm në rastet kur ZPSRK-ja nuk ka kryer hetimin apo ndjekjen penale, përndryshe kompetencat e GJE-ve janë primare (shihni nr. 1).

Si konkludim, gjithnjë është e mundur që për krimet serioze të parapara në nenet 3.3 të LmJ-së dhe në nenet 9.1 dhe 9.2 të LmZPSRK-së, të emërohet një GJE për gjykimin kryesor apo për ndonjë fazë tjetër të procedurës.

Një tjetër hipotezë mbi kompetencat shtesë të GJE-së kanë të bëjnë me a) rastet që përmbajnë elemente diskriminimi në lidhje me viktimën, premisën apo shënjestrën e kundërvajtjes (neni 3.4), b) diskualifikimin (neni 4.1 dhe 4.5) apo pamundësinë për të angazhuar një gjykatës kosovar (GJK).

Prandaj, kompetenca primare apo ekskluzive e GJE-së përfshin krimet më serioze përderisa kompetencat shtesë kryesisht mbulojnë rastet kur angazhimi i tij i përgjigjet kriterit të mundësisë.

II Udhëzime për alokimin e lëndëve penale për gjykatësit e EULEX-it në Gjykata të Qarkut

II. 1. Prapavija ligjore

Alokimi i lëndëve për gjykatësit e EULEX-it do të ndodhë në përputhje me Ligjin mbi Jurisdikcionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e Lëndëve për Gjykatësit dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053), më tutje si LmJ.

Këto udhëzime shërbejnë për të shtjelluar të drejtat mbi alokimin e lëndëve sipas ligjit të lartëpërmendur.

II. 2. Parimet

- **Transparenca**

Alokimi i lëndëve duhet të jetë transparent për akterët dhe jo-akterët në sistemin e drejtësisë.

- **Paanshmëria**

Secili duhet ta dijë paraprakisht se ku dhe te cili gjykatës ai/ajo do të gjykohet (gjykatësit nuk i përzgjedhin lëndët).

- **Fleksibiliteti**

Kushtet specifike të punës dhe numri i gjykatësve të EULEX-it dhe diskualifikimet ligjore sipas KPPPK-së duhet të merren parasysh.

- **Qëndrueshmëria**

Sistemi për alokimin e rasteve duhet të jetë shembull i administrimit të mirë të drejtësisë, të cilin gjykatësit vendorë mund (duhet) ta ndjekin në mënyrë që të mund të përmbushet qëllimi i një administrimi të pavarur, transparent dhe efikas të drejtësisë.

- **Barazimi i ngarkesës së punës për gjykatësit**

II. 3. Sistemi mbi alokimin e lëndëve

1. Gjykatësit e EULEX-it do të ndahen në dy sektorë brenda secilës gjykatë të qarkut. Njëri sektor do të merret me krimet financiare, duke përfshirë këtu edhe korrupsionin. Sektori tjetër do të merret me krimet e luftës, terrorizmin dhe krime që kanë të bëjnë me dhunën dhe/apo dëmtime trupore. Krimi i organizuar dhe ai që ka të bëjë me substanca narkotike si dhe lëndët e ndieshme si p.sh. kërcënimi apo frikësimi i një pale, dëshmitari apo gjykatësi, apo lëndë që përmbajnë elemente të krimit financiar si dhe krime që kanë të bëjnë me dhunën do të gjykohen në sektorin me të cilën lënda është më e përafërt.

2. **2.1** Që të dy sektorët e lartpërmendur do të kenë një apo dy gjykatës penalë të EULEX-it si dhe një gjykatës vendor. Njëri ndër gjykatësit e EULEX-it do të jetë Drejtuesi i Sektorit. Në gjykata me vetëm tri gjykatës penalë të EULEX-it, pra me vetëm një gjykatës penal të EULEX-it në një ndër sektorët, një gjykatës civil i EULEX-it do të caktohet në sektorin penal, mundësisht në sektorin për krime financiare.

2.2. Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e Qarkut do të vendosin se cilët do të jenë anëtarët e sektorëve dhe cili do të jetë drejtuesi i sektorit.

2.3. Kryetari i Gjykatës së Qarkut do të emërojë gjykatësit vendorë nëpër sektorë.

2.4. Gjykatësit do të jenë anëtarë të sektorëve përkatës për një periudhë prej 6 muajsh, pas së cilës do të bëhet një shqyrtim dhe po qe e mundur, një rotacion i gjykatësve nga njëri sektor në tjetrin. Edhe drejtuesi i sektorit do të qëndrojë në post për një periudhë prej 6 muajsh, pas së cilës gjykatësit e EULEX-it në gjykatën e qarkut përkatës do të marrin një vendim të ri lidhur me drejtuesin e sektorit.

2.5. Gjykatësit e caktuar në sektor do të jenë gjykatësit e panelit (*duke ushtruar kështu jurisdikcionin lidhur me lëndët e alokuara në sektor*), përmendur në LmJ, nenet 3.7 dhe 4.7 poqese nuk merret vendim tjetër nga Kryestari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it në pajtim me nenet 2.1, 3.7 dhe 4.7 të LmJ-së dhe neni 24 i KPPK-së.

2.6. Drejtuesi i Sektorit është njeriu kyq që ndërlidh sektorin me Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it. Drejtuesi i Sektorit do t'i raportojë Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mbi të gjitha lëndët e sektorit dhe çështjeve të tjera të ngjashme çdo javë. Drejtuesi i Sektorit gjithashtu do t'ia komunikojë Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it rastet kur ekziston nevoja për një panel ndryshe nga ai bazë, lartpërmendur në paragrafin 2.2.

3.1. Brenda sektorit, lëndët do t'u caktohen gjykatësve sipas sistemit numerit, me ç'rast çdo e treta lëndë që vjen në sektor do t'i caktohet gjykatësit A, çdo e treta lëndë gjykatësit B dhe çdo e treta lëndë gjykatësit C (numri 1 për gjykatësin A, numri 2 për gjykatësin B, numri 3 për gjykatësin C, numri 4 për gjykatësin A dhe kështu me rradhë). Në rastet e jashtëzakonshme (në rast të barazisë, kompleksitetit dhe numrit të lëndëve të caktuara secilit gjykatës), gjykatësi përzgjedhës mund të alokojë lëndët e përzgjedhura në një mënyrë tjetër nga ajo e lartpërmendur.

3.2. Gjykatësi të cilit iu është caktuar lënda është përgjegjës për përgatitjen e duhur të lëndës, për përbërjen e gjykimit dhe vendimeve të tjera që kanë të bëjnë me rastin.

3.3. Drejtuesi i Sektorit do të jetë kryetari i trupit gjykues.

4. Që të dy sektorët do të kenë një apo dy zyrtarë ligjorë ndërkombëtarë të EULEX-it dhe një zyrtar ligjor vendor të EULEX-it. Zyrtarët ligjorë ndërkombëtarë janë të ndërlidhur me gjykatësin përderisa zyrtarët ligjorë vendorë janë të ndërlidhur me sektorin.

5.1. Në mënyrë që të shmanget diskualifikimi i gjykatësve (KPPK neni 40 (2) në fazat e mëvonshme të lëndës, gjykatësit e EULEX-it do të caktohen kryesisht në gjyqet kryesore.

5.2. Në situatat ku ekziston nevoja të caktohet gjykatësi i EULEX-it në procedurat paraprake, apo kur ekziston nevoja për të konfirmuar procedurat e padisë apo kur duhet të zëndësohet ndonjë gjykatës për arsye të mira, kur gjykatësi penal caktohet në gjykatë tjetër të qarkut apo kur gjykatësi civil caktohet në procedurat paraprake, përfshirë edhe konfirmimin e padisë dhe urdhërimit të paraburgimit.

5.3. Gjykatësit e EULEX-it janë të vendosur në Gjykatën Supreme, apo në një apo disa prej Gjykatave të Qarkut. Caktimi I gjykatësve të EULEX-it në mënyrë se një Gjykatë të Qarkut varet nga nevoja për zëvendësim në raste të jashtëzakonshme. Në rastet e tilla, vendi kryesor I gjykatësit të EULEX-do të jetë gjykata e qarkut dhe ai do të ketë rolin e zëvendësuesit të natyrshëm të gjykatësit tjetër të EULEX-it në gjykatën tjetër të qarkut.

5.4. Vendimi kornizë i Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it do të veçojë automatizmat e zëvendësimeve si vijon:

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në një GJQ të caktuar, do të caktohen në të gjitha GJQ si zëvendësues sipas sistemit në vijim:

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në GJQ-në në **Prishtinë/Priština** do të caktohen si zëvendësues në:

1. **GJQ në Gjilan/Gnjilane**
2. **GJQ në Mitrovicë/Mitrovica**
3. **GJQ në Prizren/Prizren**
4. **GJQ në Pejë/Peć**

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në GJQ në **Pejë/Peć** do të caktohen si zëvendësues në:

1. **GJQ në Prizren/Prizren**
2. **GJQ në Prishtinë/Priština**
3. **GJQ në Gjilan/Gnjilane**
4. **GJQ në Mitrovicë/Mitrovica**

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në GJQ në **Prizren/Prizren**, do të caktohen si zëvendësues në:

1. **GJQ në Pejë/Peć**
2. **GJQ në Gjilan/Gnjilane**
3. **GJQ në Prishtinë/Priština**
4. **GJQ në Mitrovicë/Mitrovica**

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në GJQ në **Gjilan/Gnjilane** do të caktohen si zëvendësues në:

1. **GJQ në Prishtinë/Priština**
2. **GJQ në Mitrovicë/Mitrovica**
3. **GJQ në Prizren/Prizren**
4. **GJQ në Peja/Pec**

Gjykatësit të cilët në rradhë të parë janë të caktuar në GJQ në **Mitrovicë/Mitrovica** do të caktohen si zëvendësues në:

1. **GJQ në Gjilan/Gnjilane**
2. **GJQ në Prishtinë/Priština**
3. **GJQ në Prizren/Prizren**
4. **GJQ në Peja/Pec**

Kryesisht do të kërkohet nga gjykatësit e odave përkatëse, kryesues të rastit, të zëvendësojnë.

Në nrrethana të jashtëzakonshme, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të vendosin të emërojnë gjykatës civilë në lëndë specifike penale.

5.5. Sistemi i kujdestarisë do të krijohet në situatë emergjente ndërmjet gjykatave të lartëpërmendura në mënyrë që të jetë një gjykatës i disponueshëm për situatë emergjente. Kujdestaria bëhet një herë në javë, përfshirë këtu edhe fundjavat. Kryetarët e sektorëve për krime luftë në gjykata të qarkut përkatëse do t'ia dorëzojnë propozimin e sistemit rotativ Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it një muaj më parë.

3. Në rast të sëmundjes apo ndonjë situatë tjetër të papritur, zëvendësuesi do të caktohet nga sektori tjetër i gjykatës përkatëse apo nëse është e nevojshme, do të aplikohet sistemi i përshkruar në nenin 5 të lartëpërmendur.
4. Elementi monitorues i gjykatësve të EULEX-it është sipas udhëzimeve specifike të përpiluara nga Asambleja e Gjykatësve të EULEX-it.

II. 4. Caktimi i gjykimeve kryesore (dhe dëgjimeve të tjera)

Dëgjimet do të caktohen në gjykatoret e gjykatave vendore në pajtim me LmJ-në. Prandaj, gjatë caktimit të gjykimeve kryesore dhe dëgjimeve të tjera, duhet të merret parasysh që ekziston një mungesë e gjykatoreve, prandaj gjykatësit do të përdorin gjykatoret e gjykatësve vendorë, të cilët kryejnë gjykimet. Caktimi i gjykimeve duhet të bëhet në bashkëpunim me gjyqet vendore disa muaj më parë në mënyrë që lëndët të shtjellohen në mënyrë të duhur nga gjykatësit vendorë si dhe nga ata të EULEX-it, gjithnjë në pajtim me LmJ-në.